VENDIM
Nr.682, datë 5.10.2011

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR.472, DATË 2.7.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR DISIPLINIMIN E FONDEVE BUXHETORE, PËR VITIN 2011", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 16 e 40 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 10 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në fund të shkronjës "d" të pikës 1 të vendimit nr.472, datë 2.7.2011 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Përjashtimisht, ky rregull nuk zbatohet për punonjësit e Policisë së Shtetit dhe të Gardës së Republikës, që marrin pjesë në shërbime operacionale dhe kryerja e pushimeve vjetore të vitit 2010 gjatë pjesës së mbetur të vitit 2011, vlerësohet e pamundur nga titullari i institucionit."

2. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha